**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE VLORË**
**NOTER VALBONA SH. MEÇAJ**

V20230624100857228Z5

**DATE 15/08/2023**
**NR REP 1779**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 15/08/2023, para meje Notere VALBONA SH. MEÇAJ, anëtare ~~në~~ Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Vlore, HAJRO ÇAKËRRI, SULEJMAN DELVINA, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES:**
**Bianti Danaj,** atësia Sadrit, amësia Erida, shtetas Shqiptar, lindur në Ft.Lauderdale, Shtetet e Bashkuara te Amerikes (USA) dhe banues në VLORË, me adresë Nermin Vlora Falaski 04140317; Nd. 34; H. 2; Ap.7; Vlorë, lindur më 02/07/2002, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letemjoftim ID nr. 037270256 dhe nr. personal K20702073B i cili më kërkoi të vërtetoj nënshkrimin e tij.

Subjekti i mësipërm, **shtetasi Bianti Danaj** në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë; **"DONIKA OLIVE OIL", shpk** dhe nënshkruajti përpara meje Noteres, **"Vendimin nr. 1 datë 15/08/2023 të Asamblesë së të Ortakut të Vetëm"**, bashkëlidhur këtij vërtetim nënshkimi.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTERE**

VALBONA SH. MEÇAJ

PULLE TARIFE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE VLORË

NOTER VALBONA SH. MEÇAJ
ADRESA HAJRO ÇAKËRRI,
SULEJMAN DELVINA
TEL: 697478555

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 1780** **Nr. koleksioni: 968**

**Vlore më 15/08/2023**

Valbona
Mecaj

Firmosur elektronikisht nga
NISA me certifikaten
:Valbona Mecaj
Data: 2023.08.15
17:53:34+02:00

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2023062410106537458

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

NOTER VLORË

A20230624101065374S8

# KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

*( TË SHOQËRISË "DONIKA OLIVE OIL" SH.P.K)*

Sot, më datë 15/08/2023 *(dymijë e njëzetë e tre)*, para meje Notere VALBONA SH. MEÇAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Vlore, Hajro Çakërri, Sulejman Delvina, u paraqit personalisht:

**PALËT KONTRAKTUESE**

**SHITËS:**
**Bianti Danaj,** atësia Sadrit, amësia Erida, shtetas Shqiptar, lindur në Ft.Lauderdale, Shtetet e Bashkuara te Amerikes (USA) dhe banues në Vlorë, me adresë Nermin Vlora Falaski 04140317; Nd. 34; H. 2; Ap. 7; Vlorë, lindur më 02/07/2002, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letemjoftim ID nr. 037270256 dhe nr. personal K20702073B,

**BLERËS:**
**Erida Danaj,** atësia Llambi, amësia Liri, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Vlorë, me adresë Nermin Vlora Falaski 04140317; Nd. 34; H. 2; Ap. 7; Vlorë, lindur më 02/11/1975, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Letemjoftim ID nr. 036757399 dhe nr. personal H56102094R.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "sa.ma" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**Neni 1 - Objekti i Kontratës**

Bazuar ne Vendimin Nr. 01 datë 15/08/2023 te Ortakut të Vetëm të Shoqërisë « DONIKA OLIVE OIL » shpk është miratuar trasferimi i kuotës prej **76 %** *(shtatëdhjetë e gjashtë per qind)* e vlerës të kapitalit themeltar të Shoqërisë « DONIKA OLIVE OIL» shpk, te Ortaku i Ri znj. Erida Danaj.

**Objekt i kësaj Kontrate është shitja e kuotës që përbën 76%** ***(shtatëdhjetë e gjashtë për qind)*** **të kapitalit themeltar të shoqërisë : « DONIKA OLIVE OIL » shpk, nga shitësi Bianti Danaj te blerësi znj. Erida Danaj** duke u bërë në këtë mënyrë Ortak i ri në Shoqërinë « DONIKA OLIVE OIL » shpk.

**Neni 2- Çmimi i Shitjes**

Palët ranë dakort dhe me marrëveshje vendosën që :
Çmimi i shitberjes së Kuotës prej **76 %** *(shtatëdhjetë e gjashtë për qind)* të kapitalit themeltar të shoqërise « DONIKA OLIVE OIL» shpk, është në vlerën monetare **76,000** ***(shtatëdhjetë e gjashtë mijë)*** **LEKË**,.
Kjo shumë do të likujdohet nga Blerësi me nënshkrimin e kësaj kontrate.

A2023062410106537458

### Neni 3 Kalimi i Pronësisë

Që nga momenti që palët kontraktuese nënshkruajnë këtë kontratë para meje noteres, dhe me likujdimin e çmimit të shitjes Ortaku i mëparshëm Bianti Danaj zhvishet nga pronesia e kuotës, prej **76 %** (shtatë*dhjetë e gjashtë për qind*) të kapitalit themeltar e drejtë kjo që i kalon BLERËSIT respektivisht znj. ERIDA DANAJ.

Me regjistrimin e kontratës në QKB, Ortak të Shoqërisë « DONIKA OLIVE OIL» shpk njihen :

**Ortaku I -** **z.Bianti Danaj** që zotëron një Kuote prej **24 %** *(Njëzetë e katër përqind)* të Kapitalit të Shoqërisë.

**Ortaku II -** **znj. Erida Danaj** që zotëron një Kuote prej **76%** *(shtatëdhjetë e gjashtë përqind)* të Kapitalit të Shoqërisë.

Efektet e këtij çedimi përsa i përket gëzimit të kuotës së çeduar do të filloj në mënyrë te menjëhershme. Çeduesi do të marrë pjesë në fitimet apo humbjet që do të rezultojnë nga bilanci i këtij viti fiskal për periudhën deri ne zoterimin e kuotave nga shitësi
Shënimet përkatëse në librin e ortakëve dhe pranë QKB dhe këtë shitje kuotash do të bëhen nga pala blerëse.

### Neni 4 - Të Drejtat e Palëve dhe Detyrimet mes Paleve

**4.1.** Pala shitëse e garanton palën blerëse se pasuria e luajtshme objekt kontrate, është e lirë nga çdo pengesë ligjore nga pengesa dhe te drejta reale të të tretëve.
**4.2.** Pala blerëse deklaron se e njeh gjendjen reale financiare te shoqerise dhe eshte dakort per blerjen, sipas garancive dhene me lart prej pales shitese.
**4.3.** Pala shitese deklaron se nuk ka asnje pretendim kundrejt palës blerese persa i perket kesaj kontrate dhe kushteve te mësiperme, duke i deklaruar se ka marrë në dorëzim plotësisht shumen e caktuar.

### Neni 5- Baza Ligjore

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".
- Statuti i Shoqërisë "*DONIKA OLIVE OIL*shpk;
-

### Neni 6- Anekset e Kontratës

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Anekse të Kontratës;

- Vendimi i Ortakut të Vetëm të shoqërisë "DONIKA OLIVE OIL" shpk nr. 1 datë 15/08/2023
- Ekstrakt i Regjistrit Tregtar i Shoqërisë "DONIKA OLIVE OIL" shpk
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

### NENI 7 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

A20230624101065374S8

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme

**PALËT KONTRAKTUESE**

**SHITËS**

Bianti Danaj

Bianti Danaj

**BLERËS**

Erida Danaj

Erida Danaj

**NOTERE**
**VALBONA SH. MEÇAJ**